



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.730/6 prot.

Datë 30.03.2026

V E N D I M

Nr. 439/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.03.2026, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-77629-02-26-2026, me objekt: “Shërbimi i fiskalizimit të faturave”, me fond limit 2,486,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK me me NUIS L12121023B dhe adresë: Rruga “Robert Shvarec”, godina “Niku Constraksiun”, kati nr.1 teknik, hyrja nr.2, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A Rajoni Nr.1, Rruga: “Boris Plumbi”, Nr. 20, Korçë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

*Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.02.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-77629-02-26-2026, me objekt: “Shërbimi i fiskalizimit të faturave”, me fond limit 2,486,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

II.2. Në datën 06.03.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6397, protokolluar me nr. 7303/2026 prot, datë 09.03.2026, e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

“Së pari: Në shtojcën nr.6 të DST, ku specifikohen elementët e sistemit të fiskalizimit, faqja nr.42, pika 6, AK ka kërkuar që të gjenerohen raporte automatike nga sistemi si: “6. Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.”.

Sjellim në vëmendje të AK se, në zbatim të pikës 1, të nenit 41, të LPP, si dhe të pikës 1, të nenit 36 të RRPP, specifikimet teknike të shërbimeve dhe kërkesat e posaçme të tyre duhet të

përcaktohen qartë nga autoriteti kontraktor, me qëllim që OE ofertues t'u jepet mundësia të paraqesin ofertën ekonomike dhe teknike në përputhje me nevojat e AK dhe të sigurohet konkurenca e drejtë mes ofertuesve. Mospërcaktimi qartë i specifikimeve teknike nga AK, passjell konfuzion për OE dhe sjell pengesa të mëvonshme në fazën e ekzekutimit apo të përmbushjes së detyrimeve kontraktore për fituesin e saj.

Në rastin konkret, AK nuk ka përcaktuar qartë raportet dhe informacionin që kërkon të nxjerrë përmes sistemit të fiskalizimit. Kështu, AK ka lënë të hapur mundësinë e kërkesave abuzive për raportime dhe informacione të çfarëdollojshme në të ardhmen të paparashikuara nga ofertuesit, të cilat sistemi i fiskalizimit ndofta nuk mund t'i gjenerojë që të gjitha. Për rrjedhojë, meqë kjo pjesë e specifikimeve teknike është e papërcaktuar qartë nga AK, duhet të rishikohet dhe të saktësohet në përputhje me nenet 36 të LPP dhe 41 të RRPP. Pra, AK ka detyrimin që të saktësojë në mënyrë të shprehur llojet e raportimeve dhe llojin e informacionit që kërkon të nxjerrë nga sistemi i fiskalizimit.

Së dyti: *Në shtojcën nr.6, në faqet 42 dhe 43 të DST, ku janë të vendosura specifikimet teknike, AK nuk ka dhënë anjë informacion për sistemet e billingut dhe të fiskalizimit që disponon pranë tij. Me qëllim që OE ofertues të paraqesin ofertat e tyre ekonomike sipas nevojave të AK, është detyrim i AK që në bazë të nenit 41 të LPP dhe nenit 36 të RRPP, të japë informacionin e plotë për ofertuesit sa i takon sistemit të billingut dhe të fiskalizimit që disponon. Kjo pasi, dhënia e këtij informacioni jo vetëm që siguron zbatimin e parimit të transparencës në prokurimet publike, siç e kërkon neni 2 i LPP, por në të njëjtën kohë i shërben OE ofertues për të kuptuar elementët e këtyre zgjidhjeve Softwareike, si dhe mënyrën se si do të realizojë lidhjen mes sistemit të fiskalizimit dhe të billingut mbi bazën e kërkesave të AK.*

Në asnjë pjesë të DST ose të procesverbalit argumentues të tyre nuk specifikohet dhe nuk paraqitet asnjë informacion për infrastrukturën Software të sistemit/teknologjinë e sistemit të fiskalizimit dhe të billingut SHRUK Korçë SHA. E vetmja gjë që përmendet është se SHRUK Korçë SHA përmban sistemin e billingut Aal-Billing. Pra, nuk jepen as të dhënat e sistemit aktual teknologjik dhe as të komponentëve të tij si sistemi i operimit, parametrat e tij, arkitektura e sistemit, etj., ç'ka i pengon ofertuesit që të japin një ofertë ekonomike reale dhe të saktë sipas legjislacionit të prokurimit publik. Në këtë drejtim, AK ka detyrimin që të modifikojë DST sipas nenit 75 të LPP, me qëllim që t'u mundësojë OE ofertues informacion të detajuar për infrastrukturën Softwareike.

Po kështu, në asnjë pjesë të DST ose të procesverbalit argumentues të tyre nuk specifikohet dhe nuk paraqitet asnjë informacion për infrastrukturën hardware, pra për pajisjet hardware që sigurojnë funksionimin e sistemit të fiskalizimit dhe të sistemit të billingut të SHRUK Korçë SHA si pajisjet storage, serverat, vjetërsia e tyre, memoria e tyre, siguria e tyre, nëse janë të pajisura apo jo me Firewall, etj. Mungesa e këtij informacioni në DST i pengon ofertuesit që të paraqesin një ofertë të rregullt, të vlefshme dhe në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik. Dhënia e këtij informacioni është veçanërisht i rëndësishëm, edhe sa i takon kërkesave të AK për garantimin e sigurisë kibernetike. Në këtë drejtim, AK ka detyrimin që të modifikojë DST sipas nenit 75 të LPP, me qëllim që t'u japë OE ofertues informacionin e detajuar për infrastrukturën hardwareike.

Së treti: Në shtojcën nr.9 të DST, atë të kërkesave të posaçme për kapacitetet teknike, pika 2.3.5, Kreatx SHPK vëren se AK ka përcaktuar kriteret e sigurisë kibernetike në këtë mënyrë: “2.3.5 Operatoret ekonomike ne baze te Ligjit Nr. 2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike" të ndryshuar, duhet të jenë të aftë për mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit dhe mbikëqyrjen e sigurisë kibernetike te cilat duhet të përfshijnë: a) Përgjegjësinë për ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave;b) Protokolle për raportimin e incidenteve kibernetike.”.

Kreatx SHPK vlerëson se, kërkesat e posaçme të vendosura nga AK për sigurinë kibernetike në shtojcën nr.9, janë të paligjshme sepse i referohen ligjit të shfuqizuar dhe protokollit të vjetër të sigurisë kibernetike. Aktualisht, ka hyrë në fuqi dhe zbatohet ligji nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, së bashku me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, ku rëndësi të veçantë merr VKM nr.531, datë 25.09.2025, për masat teknike organizative dhe operacionale që duhet të ndjekë SHRUK Korçë SHA si operator i infrastrukturës kritike. Me kuadrin e ri legjislativ, kanë ndryshuar edhe protokollat e sigurisë edhe masat teknike, operacionale dhe organizative dhe në këto kushte kërkesat teknike për sigurinë kibernetike që janë përcaktuar në DST, duhet të zëvendësohen nga AK me të reja sipas legjislacionit në fuqi.

Rregullimi i DST sipas legjislacionit të përditësuar, përbën një detyrim ligjor për AK, meqënëse sipas DST, AK ka nevojë edhe për shërbime të këtilla në tender. Në këtë drejtim, e veçanërisht në zbatim të VKM nr.531/2025, SHRUK Korçë SHA duhet t'i bëjë të ditur OE ofertues gjendjen e sistemit të fiskalizimit dhe të billingut për sa i përket sigurisë kibernetike për infrastrukturën Softwareike dhe atë hardwareike. Për më tepër, AK duhet t'i bëjë me dije OE ofertues të gjithë informacionin e mëposhtëm. Kjo do të ndihmonte çdo OE ofertues për të llogaritur më saktë kostot e ofertës së tij ekonomike. Kështu, SHRUK Korçë SHA duhet të informojë OE me DST për:

1. Masat organizative që ka marrë për menaxhimin e riskut kibernetik dhe metodologjinë e riskut;
2. Protokollin e zbatueshëm për menaxhimin e aseteve;
3. Planin e masave të menaxhimit të incidenteve kibernetike;
4. Planin e masave për vazhdimësinë e punës (BCP);
5. Nëse përdor Redundant Array of Independent Disks;
6. Për mënyrën sesi e siguron procedurën e back-upit me Backup Lock, Retention ose “Tape Worm;
7. Vendin e rikuperimit të të dhënave nga katastrofa/Disaster Recovery Site dhe të përdorimit të Software Defined Network dhe nëse përdor apo jo Disaster Recovery;
8. Për sigurinë dhe gjendjen e pajisjeve hardwareike, ku funksionon sistemi i fiskalizimit;
9. Për mënyrën sesi monitorohen dhe regjistrohen incidentet e sigurisë kibernetike;
10. Për mjetet që përdoren për të siguruar integritetin e rrjeteve të komunikimit (“Next Generation Firewall – endpoints, VPN - zone/subnet/VLAN - Virtual Local Area Network)
11. Për sigurinë e sistemeve të teknologjisë operacionale;

12. Për sigurinë e Cloud dhe të SLA.

Për sa më lart, në zbatim të nenit 75 të LPP, AK ka detyrimin ligjor që të modifikojë DST edhe në këtë drejtim.

Së katërti: Në shtojcën nr.9 të DST, pika 2.3.4 AK kërkon që OE të paraqesë autorizimin e prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve të specifikuar vetëm për të drejtat në lidhje me procesin e fiskalizimit të faturave:- Për Programin Kompjuterik “Al Billing”.

Vendosja e kësaj kërkesë të posaçme në DST është shoqëruar nga AK me këtë argumentim: “Aktualisht Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.a përdor: Sistemin e faturimit Al Billing. Suporti i prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e suportuesve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë krijuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.”.

Kreatx SHPK vëren se, mënyra sesi kjo kërkesë e posaçme kualifikuese është përcaktuar në DST nga AK është konfuze dhe e pasaktë sepse nuk përputhet me objektin e prokurimit, si dhe nuk pajtohet as me LPP, pasi nga njëra anë objekti i prokurimit është sistemi i fiskalizimit dhe nga ana tjetër AK kërkon autorizim prodhuesi/distributori i autorizuar apo kontratë bashkëpunimi për sistemin e billingut Al-Billing, sikur të ishte ky i fundit objekt i prokurimit publik. Pra, ndonëse objekti i prokurimit është tjetër gjë, sistemi i fiskalizimit, AK vendos një kërkesë të posaçme për autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për sistemin e billingut, duke dalë fare jashtë objektit të prokurimit publik. Kjo mënyrë të vepruari, bën që AK të devijojë nga qëllimi dhe objekti i prokurimit, e për pasojë të vendosë kërkesa të posaçme të paargumentuara, që nuk pajtohen me nevojat e prokurimit dhe bien ndesh me parashikimet e LPP dhe të RRPP.

Kreatx SHPK thekson gjithashtu se, argumentimi i përdorur nga AK nuk e justifikon dhe as nuk e mbështet vendosjen e një kërkesë të tillë të posaçme kualifikuese në DST, për shkak se AK nuk ka sqaruar mjaftueshëm se përse nevojitet autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar apo kontratë bashkëpunimi për sistemin e billingut dhe jo për atë të fiskalizimit. Pra, për çfarë arsyeje nevojitet një autorizim prodhues për një sistem që nuk është objekti i prokurimit publik? Apo mos vallë synimi është kufizimi i konkurrencës në procedurat e prokurimit publik?. Mungesa e argumenteve ligjore dhe të qenësishme në këtë drejtim, sjell si pasojë vendosjen e një kërkesë të paligjshme nga AK në DST, që duhet të hiqet prej AK.

Vlen të sjellim në vëmendje të AK se, sipas paragrafit të dytë të nenit 77 të LPP, kërkesat e posaçme kualifikuese kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë

proporcionale me objektin e kontratës, pasi përndryshe konsiderohen të paligjshme dhe ndesh me LPP. Në kushtet kur kjo kërkesëe posaçme që ka vendosur AK bie ndesh me nenin 77 të LPP, ajo duhet të hiqet nga DST prej AK, duke i modifikuar ato sipas nenit 75 të LPP.

Shkelja e LPP nga AK thellohet edhe më tej nga mënyra sesi është shkruar kërkesa e posaçme në DST, pra pa u shoqëruar me termin ekuivalent, siç e kërkon neni 36 i LPP. Sipas nenit 36 të LPP, çdo markë, patentë apo e drejtë e veçantë atutori që përmendet në DST duhet të shoqërohet me termin ekuivalent, pasi përndryshe përbën një kërkesë të vendosur në DST në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik. Edhe sikur të justifikohet nga AK një kërkesë e tillë e posaçme në DST, ajo nuk mund të vendoset pa u shoqëruar me termin ekuivalent. Në këtë drejtim, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.265/2026, si dhe vetë KSHA pranë SHRUK Korçë SHA me vendimin nr.1/2026, ka mbajtur qëndrimin se, kur kërkohet përmirësimi i sistemit AL -Billing si prokurim publik i posaçëm, AK ka detyrimin që të vendosë në DST termin ekuivalent pas këtij emrit të sistemit, duke pranuar edhe oferta nga OE me sisteme ekuivalente. Nisur nga precedenti administrativ, vendimi nr.265/2026 i KPP, AK duhet të kishte shoqëruar kërkesën e posaçme për autorizim nga prodhuesi për sistemin Al-Billing me termin ose ekuivalent. Fakti që nuk e ka kryer një veprim të tillë, tregon qasjen e AK për të kufizuar pjesëmarrjen dhe konkurrencën e OE në prokurimin publik, në kundërshtim me sa urdhëron neni 2 i LPP.

Kreatx SHPK thekson se kërkesa e posaçme për autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar/kontratë bashkëpunimi përs sistemin Al-Billing është totalisht fiktive dhe abuzive, me qëllimin e vetëm për të kufizuar OE që të ofertojnë në prokurimin publik, pasi në dy procedurat e tjera që SHRUK Korçë SHA ka zhvilluar, të cilat kanë qenë të dedikuara për përmirësimin e sistemit Al-Billing, përtej autorizimit nga prodhuesi për këtë sistem janë pranuar oferta me sisteme ekuivalente. Pra, SHRUK Korçë SHA ka lejuar OE që të ofertojnë me sisteme ekuivalente, ndërkohë që tek kjo procedurë prokurimi objekt ankimi nuk ka lënë hapësirë për një gjë të tillë. Procedurat e prokurimit ku është lejuar ofertimi me sistem ekuivalent të Al-Billing janë:

1. Procedura aktuale në ankim administrativ pranë KPP me REF-65394-10-16-2025, me objekt “Blerje shërbimi për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit Al Billing, sistemit ËAMR, SQL server oracle, data base Omega Core Audit”, me fond limit 9 462 524 Lekë pa TVSH. Për këtë, si dokumentacion provues shërben vendimi nr.265/2026 i KPP dhe vendimi nr.1/2026 i KSHA pranë SHRUK Korçë SHA. Tek kjo procedurë prokurimi oferta e Kreatx SHPK është pranuar me sistemin ekuivalent të Al-Billing atë Flare-Billing.

2. Procedura e prokurimit publik e përmbyllur me sukses nga Kreatx SHPK me kontratën nr.335/22 prot., datë 14.10.2022, me objekt “Përditësimi i programit të faturimit, migrimi i të dhënave, audit dhe ëeb sevice për pagesat e faturave të ujit të pijshëm”, me vlerë 2 754 000 Lekë pa TVSH. Tek kjo procedurë e fundit, si dokumentacion provues do të gjeni kontratën e nënshkruar mes SHRUK Korçë SHA dhe Kreatx SHPK, tek e cila jemi shpallur fitues me sistemin ekuivalent Flare Billing. Gjithashtu, do të gjeni edhe vërtetimin e realizimit të kontratës me sukses nga AK.

Në vijim të argumentimit, fiktiviteti i kërkesës së posaçme për autorizim nga prodhuesi i sistemit Al-Billing provohet edhe nga fakti se, për vite me radhë Kreatx SHPK ka realizuar me

sukses shërbimin e fiskalizimit për disa AK, duke përfshirë edhe SHRUK Korçë SHA, që kanë pasur të implementuar si sistem billingu atë Al-Billing. Në të gjitha këto raste, ofertimi i Kreatx SHPK është bërë me sistemin ekuivalent Flare Billing. Si dokumentacion provues do të gjeni:

- 1. Kontrata administrative nr.114/6 prot., datë 23.07.2024, me objekt “Shërbimi fiskalizimi të faturave të shitjes”, me vlerë 400 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Lushnjë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.1067/1 prot., datë 07.11.2025 nga AK.*
- 2. Kontrata administrative nr.159/7 prot., datë 19.05.2022, me objekt “Fiskalizimi i faturave dhe veprimeve të arkave”, me vlerë 480 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.219/1 prot., datë 27.03.2023 nga AK.*
- 3. Kontrata administrative nr.1067/5 prot., datë 02.08.2023, me objekt “Fiskalizim i faturave të shitjes”, me vlerë 491 666.5 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Lushnjë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.1533/1 prot., datë 07.11.2024 nga AK.*
- 4. Kontrata administrative nr.1736 prot., datë 31.10.2022, me objekt “Shërbimi i fiskalizimit”, me vlerë 620 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Shkodër SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing.*
- 5. Kontrata administrative nr.439/6 prot., datë 23.12.2022, me objekt “Blerje shërbimi zhvillime dhe konfigurime për sistemin e fiskalizimit të faturave tatimore elektronike”, me vlerë 340 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.289/1 prot., datë 20.04.2023 nga AK.*

Të gjitha sa më lart, tregojnë qartë se kërkesa e posaçme për autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar/kontratë bashkëpunimi për sistemin Al-Billing bie ndesh me praktikën administrative të prokurimit publik dhe me legjislacionin e prokurimit publik. Në këndvështrimin e mësipërm, AK duhet të heqë nga DST kërkesën e posaçme për autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar/kontratë bashkëpunimi për sistemin Al-Billing, pasi bie ndesh me nenet 2 dhe 77, të LPP.

Nga ana tjetër, qartësojë në DST nëse nevojitet apo jo autorizimi nga prodhuesit/distributori i autorizuar/kontratë bashkëpunimi për sistemin ekzistues të fiskalizimit që ka të instaluar/implementuar pranë institucionit apo nëse nevojitet autorizim nga prodhuesi për implementimin e një sistemi të ri të ndryshëm nga ai ekzistues pranë tij. Prandaj, AK duhet të sqarojë në DST të gjithë OE ofertues për zgjidhjen ekzistuese Softwareike të fiskalizimit pranë tij. Në praktikën administrative të prokurimit publik, autorizimi nga prodhuesi kërkohet vetëm për implementimin e sistemeve të reja të fiskalizimit dhe jo për mirëmbajtjen e një sistemi ekzistues.

Nëse bëhet fjalë për blerjen dhe implementimin e një sistemi të ri fiskalizimi, nevojitet autorizim prodhuesi për sistemin e ri dhe duhet të ndryshojë gjithashtu objekti i prokurimit në “Blerjen dhe implementimin e sistemit të fiskalizimit dhe mirëmbajtjen e tij”. Po kështu, për efekt të

blerjes së sistemit të ri, duhet të shtohen edhe shërbimet e tjera si testimi i sistemit, migrimi i të dhënave, dorëzimi i licencave, etj. Në të njëjtën kohë, për mbarëvajtjen e punës së sistemit të ri, nevojitet shtimi në DST edhe i certifikimeve të punonjësve kompetentë për t'ua implementuar atë sipas nevojave të AK.

Për sa më lart, si dhe në zbatim të nenit 75 të LPP, Kreatx SHPK kërkon:

1. Pranimin e ankimit administrativ;

2. Modifikimin e DST nga AK në përputhje me argumentimin e dhëna në përmbajtjen e këtij ankimi administrativ.”

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 10.03.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr.730/1 prot., Vendimi nr.1 i KSHA-së nr. 355/18 prot., datë 10.03.2026 ardhur nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të KPP-së dhe në datën 17.03.2026 është protokolluar në KPP me nr. 730/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 355/19 prot., datë 10.03.2026 me objekt: “Shkresë përcjellëse Vendimi nr. 1 i KSHA-së për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK. Referuar vendimit të KSHA-së rezulton se ankesa e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK është refuzuar nga ky komision.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK, të parashtruara në pikën 1 dhe 2 të ankesës se: “Në shtojcën nr.6 të DST, ku specifikohen elementët e sistemit të fiskalizimit, faqja nr.42, pika 6, AK ka kërkuar që të gjenerohen raporte automatike nga sistemi si: “6. Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.”.

Sjellim në vëmendje të AK se, në zbatim të pikës 1, të nenit 41, të LPP, si dhe të pikës 1, të nenit 36 të RRPP, specifikimet teknike të shërbimeve dhe kërkesat e posaçme të tyre duhet të përcaktohen qartë nga autoriteti kontraktor, me qëllim që OE ofertues t'u jepet mundësia të paraqesin ofertën ekonomike dhe teknike në përputhje me nevojat e AK dhe të sigurohet konkurrenca e drejtë mes ofertuesve. Mospërcaktimi qartë i specifikimeve teknike nga AK, passjell konfuzion për OE dhe sjell pengesa të mëvonshme në fazën e ekzekutimit apo të përmbushjes së detyrimeve kontraktore për fituesin e saj.

Në rastin konkret, AK nuk ka përcaktuar qartë raportet dhe informacionin që kërkon të nxjerrë përmes sistemit të fiskalizimit. Kështu, AK ka lënë të hapur mundësinë e kërkesave abuzive për raportime dhe informacione të çfarëdollojshme në të ardhmen të paparashikuara nga ofertuesit, të cilat sistemi i fiskalizimit ndofta nuk mund t'i gjenerojë që të gjitha. Për rrjedhojë, meqë kjo pjesë e specifikimeve teknike është e papërcaktuar qartë nga AK, duhet të rishikohet dhe të saktësohet në përputhje me nenet 36 të LPP dhe 41 të RRPP. Pra, AK ka detyrimin që të saktësojë në mënyrë të shprehur llojet e raportimeve dhe llojin e informacionit që kërkon të nxjerrë nga sistemi i fiskalizimit.

Së dyti: Në shtojcën nr.6, në faqet 42 dhe 43 të DST, ku janë të vendosura specifikimet teknike, AK nuk ka dhënë anjë informacion për sistemet e billingut dhe të fiskalizimit që disponon pranë tij. Me qëllim që OE ofertues të paraqesin ofertat e tyre ekonomike sipas nevojave të AK, është detyrim i AK që në bazë të nenit 41 të LPP dhe nenit 36 të RRPP, të japë informacionin e plotë për ofertuesit sa i takon sistemit të billingut dhe të fiskalizimit që disponon. Kjo pasi, dhënia e këtij informacioni jo vetëm që siguron zbatimin e parimit të transparencës në prokurimet publike, siç e kërkon neni 2 i LPP, por në të njëjtën kohë i shërben OE ofertues për të kuptuar elementët e këtyre zgjidhjeve Softwareike, si dhe mënyrën se si do të realizojë lidhjen mes sistemit të fiskalizimit dhe të billingut mbi bazën e kërkesave të AK.

Në asnjë pjesë të DST ose të procesverbalit argumentues të tyre nuk specifikohet dhe nuk paraqitet asnjë informacion për infrastrukturën Software të sistemit/teknologjinë e sistemit të fiskalizimit dhe të billingut SHRUK Korçë SHA. E vetmja gjë që përmendet është se SHRUK Korçë SHAa përmban sistemin e billingut Aal-Billing. Pra, nuk jepen as të dhënat e sistemit aktual teknologjik dhe as të komponentëve të tij si sistemi i operimit, parametrat e tij, arkitektura e sistemit, etj., çka i pengon ofertuesit që të japin një ofertë ekonomike reale dhe të saktë sipas legjislacionit të prokurimit publik. Në këtë drejtim, AK ka detyrimin që të modifikojë DST sipas nenit 75 të LPP, me qëllim që t'u mundësojë OE ofertues informacionin të detajuar për infrastrukturën Softwareike.

Po kështu, në asnjë pjesë të DST ose të procesverbalit argumentues të tyre nuk specifikohet dhe nuk paraqitet asnjë informacion për infrastrukturën hardware, pra për pajisjet hardware që sigurojnë funksionimin e sistemit të fiskalizimit dhe të sistemit të billingut të SHRUK Korçë SHA si pajisjet storage, serverat, vjetërsia e tyre, memoria e tyre, siguria e tyre, nëse janë të pajisura apo jo me Firewall, etj. Mungesa e këtij informacioni në DST i pengon ofertuesit që të paraqesin një ofertë të rregullt, të vlefshme dhe në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik. Dhënia e këtij informacioni është veçanërisht i rëndësishëm, edhe sa i takon kërkesave të AK për garantimin e sigurisë kibernetike. Në këtë drejtim, AK ka detyrimin që të modifikojë DST sipas nenit 75 të LPP, me qëllim që t'u japë OE ofertues informacionin e detajuar për infrastrukturën hardwareike.”

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, “Të dhëna teknike që kërkohen për programin dhe shërbimin e fiskalizimit”, pika 6, të dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se është kërkuar si vijon:

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;*
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Të dhëna teknike që kërkohen për programin dhe shërbimin e fiskalizimit:

- 1. Të regjistrojë shpejt dhe lehtë faturat elektronike, ku përfshihen faturat elektronike, faturat pa para ne dore, faturat me para ne dore, faturat shoqeruese dhe veprimet e arkave.*
- 2. Të jetë i integruar me sistemin e faturimit Al-Billing që është në përdorim nga UKRK SH.A. Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga sistemi i faturimit dhe të fiskalizohen.*
- 3. Faturat për veprimet të cilat nuk përfshihen në sistemin e faturimit Al-Billing, si psh lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen manualisht.*
- 4. Të jetë i integruar me sistemin e faturimit Al-Billing që është në përdorim nga UKRK SH.A. për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për arketimet e faturave.*
- 5. Të dërgojë në shërbimin e fiskalizimit pagesat faturave elektronike, të cilat nuk raportohen nga bankat e nivelit të dytë.*
- 6. Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.*

7 Numri total i faturave të kërkuara për t'u fiskalizuar në muaj është 57000.

Operatori Ekonomik duhet të ketë zgjidhjen e çertifikuar të Software-it në formën e një aplikacioni

individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

1. krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;

2. vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;

3. dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur çertifikatën elektronike;

4. lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;

5. transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit

6. konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese;

7. ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;

8. gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);

9. gjenerimin e kodit QR;

10. printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;

11. të sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve

fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit.

12. Sipas nenit 9 të Ligjit, për zbatimin e procedurës së fiskalizimit të faturave të lëshuara, Elementi i detyrueshëm i secilës faturë është, ndër të tjera, NIVF, i cili identifikon në mënyrë unike çdo faturë dhe konfirmon që fatura është regjistruar në bazën e të dhënave të administratës tatimore qendrore.

Funksione të tjera që duhet të ketë programi:

1. Bazat e të dhënave, të jenë të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi

2. Të ofrojë mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cilit përdorues apo rol ; të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara

3. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.

4. Të hap llogari për operatorët përdorues sipas kërkeses së AK si dhe një llogari administrator i cili të mund të shikojë veprimet e tij dhe të tjereve si dhe të gjenerojë raportet e nevojshme lidhur me librat e shitjeve, librat e blerjeve, artikujve etj.

5. Të ofrojë mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara

6. Të mundesojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.

7. Të mundesojë regjistrimin e datës, orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.

8. Të mundesojë historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.

9. Backup. Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup. ”

III.1.3. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, në thelb, janë paqartësi mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe hartimit të ofertës teknike. Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka sqaruar si vijon:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vlerëson se specifikimet teknike të vendosura për procedurën e prokurimit objekt ankimi janë të qarta, të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe në përputhje të plotë me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi në rastin konkret përcaktojnë qartë funksionet dhe shërbimet që duhet të ofrohen, duke mos lënë hapësirë për keqinterpretim në rradhët e operatorëve ekonomikë të interesuar për pjesmarrje apo për kërkesa jashtë objektit të kontratës gjatë fazës së zbatimit të saj sikundër pretendon ankimuesi. Në specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë të detajuar funksionet kryesore të sistemit, ndër të cilat përfshihet dhe pika e pretenduar nga OE si e paqartë

6. Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.

Kjo kërkesë është tërësisht e qartë dhe nënkupton se sistemi duhet të jetë në gjendje të krijojë raporte për faturat, duke treguar nëse ato janë fiskalizuar apo jo. Pra, sistemi duhet të mundësojë gjenerimin e raporteve që përmbajnë informacion mbi faturat e krijuara në sistem. Këto raporte duhet të tregojnë nëse një faturë është fiskalizuar me sukses në sistemin e tatimeve apo nëse ende nuk është fiskalizuar. Përmes këtyre raporteve përdoruesi (AK) mund të kontrollojë statusin e faturave, të identifikojë faturat që kanë dështuar në fiskalizim dhe të marrë masa për korrigjimin ose rifiskalizimin e tyre. Në këtë kuadër, kërkesa që sistemi të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat e fiskalizuara ose jo përbën një funksionalitet standard të çdo sistemi fiskalizimi dhe lidhet drejtpërdrejtë me monitorimin dhe kontrollin e procesit të fiskalizimit të faturave.

1.7. Në lidhje me pretendimin se në dokumentet e tenderit nuk është dhënë informacion për sistemet e billing-ut dhe të fiskalizimit, KSHA vëren se në dokumentacionin e procedurës është specifikuar qartë sistemi i faturimit në të cilin do të implementohet shërbimi i fiskalizimit, konkretisht sistemi AlBilling, i cili është sistemi aktual i përdorur nga institucioni për menaxhimin e faturimit. Objekti i procedurës është Shërbimi i fiskalizimit, jo zhvillimi apo furnizimi i një sistemi të ri billing. Në këtë rast është normale që AK të tregojë në cilin sistem faturimi do të integrohet shërbimi, në mënyrë që operatorët ekonomikë të kuptojnë kontekstin e implementimit. Permendja e sistemin Al Billing nuk është mungesë informacioni, përkundrazi është qartësim për ofertuesit lidhur me mjedisin ku do të implementohet shërbimi i kërkuar.

Sa i përket pretendimit për mungesë informacioni mbi arkitekturën teknologjike të sistemit ekzistues. KSHA sqaron se në dokumentet e tenderit janë dhënë informacionet e nevojshme mbi mjedisin ku do të realizohet implementimi i shërbimit të fiskalizimit, në një nivel të mjaftueshëm për t'u mundësuar operatorëve ekonomikë vlerësimin e kapaciteteve të tyre për realizimin e këtij shërbimi. Operatorët ekonomikë, si subjekte të specializuara në këtë fushë, kanë përgjegjësinë profesionale të analizojnë kërkesat funksionale dhe të vlerësojnë nëse zgjidhjet e tyre teknologjike mund të realizojnë integrimin e kërkuar. Për rrjedhojë, mungesa e detajeve

të brendshme të arkitekturës teknologjike e pretenduar nga ankimuesi nuk përbën pengesë për paraqitjen e një oferte të vlefshme dhe reale.

1.8. Në lidhje me pretendimin për mungesë informacioni mbi infrastrukturën hardware të përdorur për funksionimin e sistemit të billing-ut dhe të fiskalizimit, KSHA sie është shprehur dhe më lart në dokumentet e tenderit janë dhënë të dhëna të përgjithshme mbi infrastrukturën ekzistuese, të cilat janë të mjaftueshme për qëllimin e kësaj procedure. Detaje të tilla si konfigurimet specifike të serverëve, parametrat e memories, vjetërsia e pajisjeve, apo elementë të tjerë të sigurisë së brendshme të infrastrukturës përbëjnë informacion teknik të brendshëm dhe nuk janë të domosdoshëm për përllogaritjen e ofertës ekonomike për shërbimin e kërkuar. Për më tepër, objekti i kontratës nuk përfshin furnizimin ose mirëmbajtjen e infrastrukturës hardware, por ofrimin e shërbimit të fiskalizimit dhe integrimin e tij me sistemin ekzistues të taturimit. Në këtë kuptim, operatorët ekonomikë duhet të ofrojnë një zgjidhje që mund të funksionojë në një mjedis standard të infrastrukturës teknologjike, ndërsa vlerësimi i përputhshmërisë së zgjidhjes së tyre me mjedisin ekzistues bëhet në bazë të kërkesave funksionale të përcaktuara në dokumentacion.

Gjithashtu duhet theksuar se Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Korçë operon në një mjedis të klasifikuar si infrastrukturë kritike dhe subjekt i kërkesave për siguri kibernetike sipas standardeve të përcaktuara nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, ndaj publikimi i detajeve të plota mbi arkitekturën e brendshme teknologjike dhe konfigurimet specifike të sistemit nuk është i mundur përtej informacionit të përgjithshëm të dhënë në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nul qëndrojnë.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” thuhet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III .1.5. Referuar nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”, “ 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.1.6. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë

e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.1.7. Në nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” të LPP-së thuhet shprehimisht se: “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.”

III.1.8. Sa më sipër cituar rezulton se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues janë paqartësi mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe hartimit të ofertës teknike. Autoriteti kontraktor ka dhënë sqarime por KPP gjykon se këto sqarime nuk janë shteruese, pasi autoriteti kontraktor nuk ka dhënë shpjeguar qartësisht dhe konkretisht për raportet dhe

informacionin që kërkon të nxjerrë përmes sistemit të fiskalizimit si dhe nuk ka dhënë sqarime të hollësishme për sistemet e billingut dhe të fiskalizimit që disponon, në mënyrë që ofertesit të qartësohen lidhur me hartimin e ofertës teknike dhe ekonomike.

Për pasojë, KPP gjykon se autoriteti kontraktor përveçse të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese për të gjitha paqartësitë e tij, por këto sqarime duhet tu bëhen me dije edhe ofertuesve të interesuar për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: *“Së treti: Në shtojcën nr.9 të DST, atë të kërkesave të posaçme për kapacitetet teknike, pika 2.3.5, Kreatx SHPK vëren se AK ka përcaktuar kriteret e sigurisë kibernetike në këtë mënyrë: “2.3.5 Operatoret ekonomike ne baze te Ligjit Nr. 2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike" të ndryshuar, duhet të jenë të aftë për mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit dhe mbikëqyrjen e sigurisë kibernetike te cilat duhet të përfshijnë: a) Përgjegjësinë për ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave;b) Protokolle për raportimin e incidenteve kibernetike.”.*

Kreatx SHPK vlerëson se, kërkesat e posaçme të vendosura nga AK për sigurinë kibernetike në shtojcën nr.9, janë të paligjshme sepse i referohen ligjit të shfuqizuar dhe protokollit të vjetër të sigurisë kibernetike. Aktualisht, ka hyrë në fuqi dhe zbatohet ligji nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, së bashku me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, ku rëndësi të veçantë merr VKM nr.531, datë 25.09.2025, për masat teknike organizative dhe operacionale që duhet të ndjekë SHRUK Korçë SHA si operator i infrastrukturës kritike. Me kuadrin e ri legjislativ, kanë ndryshuar edhe protokollin e sigurisë edhe masat teknike, operacionale dhe organizative dhe në këto kushte kërkesat teknike për sigurinë kibernetike që janë përcaktuar në DST, duhet të zëvendësohen nga AK me të reja sipas legjislacionit në fuqi.

Rregullimi i DST sipas legjislacionit të përditësuar, përbën një detyrim ligjor për AK, meqënëse sipas DST, AK ka nevojë edhe për shërbime të këtitilla në tender. Në këtë drejtim, e veçanërisht në zbatim të VKM nr.531/2025, SHRUK Korçë SHA duhet t'i bëjë të ditur OE ofertues gjendjen e sistemit të fiskalizimit dhe të billingut për sa i përket sigurisë kibernetike për infrastrukturën Softwareike dhe atë hardwareike. Për më tepër, AK duhet t'i bëjë me dije OE ofertues të gjithë informacionin e mëposhtëm. Kjo do të ndihmonte çdo OE ofertues për të llogaritur më saktë kostot e ofertës së tij ekonomike. Kështu, SHRUK Korçë SHA duhet të informojë OE me DST për:

- 1. Masat organizative që ka marrë për menaxhimin e riskut kibernetik dhe metodologjinë e riskut;*
- 2. Protokollin e zbatueshëm për menaxhimin e aseteve;*
- 3. Planin e masave të menaxhimit të incidenteve kibernetike;*
- 4. Planin e masave për vazhdimësinë e punës (BCP);*
- 5. Nëse përdor Redundant Array of Independent Disks;*

6. Për mënyrën sesi e siguron procedurën e back-upit me Backup Lock, Retention ose "Tape Worm;
7. Vendin e rikuperimit të të dhënave nga katastrofa/Disaster Recovery Site dhe të përdorimit të Software Defined Network dhe nëse përdor apo jo Disaster Recovery;
8. Për sigurinë dhe gjendjen e pajisjeve hardwareike, ku funksionon sistemi i fiskalizimit;
9. Për mënyrën sesi monitorohen dhe regjistrohen incidentet e sigurisë kibernetike;
10. Për mjetet që përdoren për të siguruar integritetin e rrjeteve të komunikimit ("Next Generation Firewall – endpoints, VPN - zone/subnet/VLAN - Virtual Local Area Network)
11. Për sigurinë e sistemeve të teknologjisë operacionale;
12. Për sigurinë e Cloud dhe të SLA.

Për sa më lart, në zbatim të nenit 75 të LPP, AK ka detyrimin ligjor që të modifikojë DST edhe në këtë drejtim.

”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Referuar përgjigjes së dhënë ankimesit rezulton se KSHA-ja nuk i ka pranuar pretendimet e tij, duke argumentuar si vijon:

“Lidhur me pretendimet e ankimesit për modifikimin e kriterit të përcaktuar në shtojcën 9 të DT, pika 2.3.5 “Operatorët ekonomike në baze të Ligjit Nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike” të ndryshuar, duhet të jenë të aftë për mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit dhe mbikëqyrjen e sigurisë kibernetike të cilat duhet të përfshijnë: a) Përgjegjësinë për ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave; b) Protokolle për raportimin e incidenteve kibernetike KSHA sqaron se sa i përket referimit në DT të ligjit nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kontraktor pranon se bëhet fjalë për lapsus, pasi ligji është shfuqizuar dhe zëvendësuar nga ligji nr. 25/2024. Referimi përdoret në mënyrë të përgjithshme për të përcaktuar parimet bazë të sigurisë kibernetike, si ruajtja e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave dhe detyrimin për raportimin e incidenteve. Në kuadrin e ri ligjor, SHRUK Korçë SHA është pjesë e infrastrukturës kritike, dhe ligji nr. 25/2024 do të zëvendësojë referimin e gabuar në DST. KSHA gjithashtu qartëson se në kuadër të një procedure të hapur prokurimi mbi shërbimin e fiskalizimit, AK nuk ka asnjë detyrim ligjor për të zbuluar masat konkrete të vendosura nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) të dërguara në mënyrë konfidenciale për SHRUK Korçë SHA. Sipas ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, si dhe aktet nënligjore për zbatim, të gjitha masat operative, teknike dhe organizative të sigurisë kibernetike janë konfidenciale dhe nuk mund të publikohen. Në këtë kontekst, nuk është e detyrueshme dhe nuk kërkohet që ofertuesit të kenë akses ose të zbatojnë protokolle të tilla të detajuara, si menaxhimi i aseteve, planet për incidente kibernetike, BCP, konfigurimet e RAID, procedurat e backup-it, vendet e rikuperimit të të dhënave, ose përdorimi i Software Defined Network dhe Disaster Recovery. Objekti i këtij tenderi është shërbimi i fiskalizimit, dhe informacioni i dhënë në DST është i mjaftueshëm që operatorët ekonomikë të vlerësojnë nëse janë të aftë për të ofruar këtë shërbim, pa nevojën e aksesit tek masat konfidenciale të AKSK-së.

Informacioni i dhënë në DT është i mjaftueshëm që operatorët ekonomikë të interesuar për pjesmarrje të vlerësojnë në bazë të kapaciteteve të tyre nëse mund të ofrojnë shërbimin e fiskalizimit sipas kërkesave funksionale.

Çdo kriter shitesë lidhur me inrastrukturën dhe sigurinë kibernetike që vendoset në momente të tjera bëhet i ditur dhe zbatohet vetëm për operatorin ekonomik fitues përmes kontratës ose marrëveshjeve të veçanta; e gjithë kjo lidhet vetëm me objektin e kontratës dhe nuk ka të bëjë me zbatimin e shërbimit të fiskalizimit nga ofertuesit gjatë procedurës së tenderit, duke mos detyruar ata të ndjekin çdo masë konfidenciale të sigurisë të vendosura nga AKSK.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë..”

III.2.3. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5. e diokumentave të tenderit të publikuara në SPE pjesë e dokumentave të tenderit, të publikuara në SPE, rezulton se, nga ana e autoritetit kontraktor, është kërkuar:

2.3.5 Operatoret ekonomike ne baze te Ligjit Nr. 2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike" të ndryshuar, duhet të jenë të aftë për mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit dhe mbikëqyrjen e sigurisë kibernetike te cilat duhet të përfshijnë:

- a) Përgjegjësinë për ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave;*
- b) Protokolle për raportimin e incidenteve kibernetike.*

III.2.4. Në nenin 49 “Shfuqizime” të ligjit nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, thuhet shprehimisht se:

Neni 49 Shfuqizime

- 1. Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike” shfuqizohet.*
- 2. Nenet 10 dhe 10/1 të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, shfuqizohen.*
- 3. Aktet nënligjore, të miratuara në zbatim të ligjit nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”, mbeten në fuqi edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kur nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.*

III.2.5. VKM-në Nr. 531, datë 25.9.2025 “Për përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë kibernetike dhe kategorizimin e afateve të masave korrigjuese në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 20, pika 5, e 43, pika 5, të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, vendosi:

- 1. Miratimin e përmbajtjes dhe mënyrës së dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë kibernetike në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit dhe të kategorizimit të afateve të masave korrigjuese, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*
- 2. Ngarkohen operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit për zbatimin e këtij vendimi.*

III.2.6. Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se baza ligjore e përcaktuar nga autoriteti kontraktor për sigurinë kibernetike në dokumentat e procedurës së mësipërme të prokurimit, është e bazuar në ligjin nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetikë”, shfuqizuar me ligjin nr. 25/2025 “Për sigurinë kibernetike”.

Në këto kushte autoriteti kontraktor duhet të ndryshojë bazën ligjore dhe kërkesat e tij të parashikuara në dokumentat e tenderit si më sipër cituar, në përputhje me ligjin nr. 25/2025 “Për sigurinë kibernetike” dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Pretendimet e ankimesit qëndrojnë.

III.3. **Së katërti:** Në shtojcën nr.9 të DST, pika 2.3.4 AK kërkon që OE të paraqesë autorizimin e prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve të specifikuar vetëm për të drejtat në lidhje me procesin e fiskalizimit të faturave:- Për Programin Kompjuterik “Al Billing”.

Vendosja e kësaj kërkesë të posaçme në DST është shoqëruar nga AK me këtë argumentim: “Aktualisht Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.a përdor: Sistemin e faturimit Al Billing. Suporti i prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e suportuesve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë krijuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.”

Kreatx SHPK vëren se, mënyra sesi kjo kërkesë e posaçme kualifikuese është përcaktuar në DST nga AK është konfuze dhe e pasaktë sepse nuk përputhet me objektin e prokurimit, si dhe nuk pajtohet as me LPP, pasi nga njëra anë objekti i prokurimit është sistemi i fiskalizimit dhe nga ana tjetër AK kërkon autorizim prodhuesi/distributori i autorizuar apo kontratë bashkëpunimi për sistemin e billingut Al-Billing, sikur të ishte ky i fundit objekt i prokurimit publik. Pra, ndonëse objekti i prokurimit është tjetër gjë, sistemi i fiskalizimit, AK vendos një kërkesë të posaçme për autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për sistemin e billingut, duke dalë fare jashtë objektit të prokurimit publik. Kjo mënyrë të vepruari, bën që AK të devijojë nga qëllimi dhe objekti i prokurimit, e për pasojë të vendosë kërkesa të posaçme të paargumentuara, që nuk pajtohen me nevojat e prokurimit dhe bien ndesh me parashikimet e LPP dhe të RRPP.

Kreatx SHPK thekson gjithashtu se, argumentimi i përdorur nga AK nuk e justifikon dhe as nuk e mbështet vendosjen e një kërkesë të tillë të posaçme kualifikuese në DST, për shkak se AK nuk ka sqaruar mjaftueshëm se përse nevojitet autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar apo kontratë bashkëpunimi për sistemin e billingut dhe jo për atë të fiskalizimit. Pra, për çfarë arsyeje nevojitet një autorizim prodhues për një sistem që nuk është objekti i prokurimit publik? Apo mos vallë synimi është kufizimi i konkurrencës në procedurat e prokurimit publik?. Mungesa e argumenteve ligjore dhe të qenësishme në këtë drejtim, sjell si pasojë vendosjen e një kërkesë të paligjshme nga AK në DST, që duhet të hiqet prej AK.

Vlen të sjellim në vëmendje të AK se, sipas paragrafit të dytë të nenit 77 të LPP, kërkesat e posaçme kualifikuese kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, pasi përndryshe konsiderohen të paligjshme dhe ndesh me LPP. Në kushtet kur kjo kërkesë e posaçme që ka vendosur AK bie ndesh me nenin 77 të LPP, ajo duhet të hiqet nga DST prej AK, duke i modifikuar ato sipas nenit 75 të LPP.

Shkelja e LPP nga AK thellohet edhe më tej nga mënyra sesi është shkruar kërkesa e posaçme në DST, pra pa u shoqëruar me termin ekuivalent, siç e kërkon neni 36 i LPP. Sipas nenit 36 të LPP, çdo markë, patentë apo e drejtë e veçantë atutori që përmendet në DST duhet të shoqërohet me termin ekuivalent, pasi përndryshe përbën një kërkesë të vendosur në DST në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik. Edhe sikur të justifikohet nga AK një kërkesë e tillë e posaçme në DST, ajo nuk mund të vendoset pa u shoqëruar me termin ekuivalent. Në këtë drejtim, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.265/2026, si dhe vetë KSHA pranë SHRUK Korçë SHA me vendimin nr.1/2026, ka mbajtur qëndrimin se, kur kërkohet përmirësimi i sistemit AL -Billing si prokurim publik i posaçëm, AK ka detyrimin që të vendosë në DST termin ekuivalent pas këtij emrit të sistemit, duke pranuar edhe oferta nga OE me sisteme ekuivalente. Nisur nga precedenti administrativ, vendimi nr.265/2026 i KPP, AK duhet të kishte shoqëruar kërkesën e posaçme për autorizim nga prodhuesi për sistemin Al-Billing me termin ose ekuivalent. Fakti që nuk e ka kryer një veprim të tillë, tregon qasjen e AK për të kufizuar pjesëmarrjen dhe konkurrencën e OE në prokurimin publik, në kundërshtim me sa urdhëron neni 2 i LPP.

Kreatx SHPK thekson se kërkesa e posaçme për autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar/kontratë bashkëpunimi përs sistemin Al-Billing është totalisht fiktive dhe abuzive, me qëllimin e vetëm për të kufizuar OE që të ofertojnë në prokurimin publik, pasi në dy procedurat e tjera që SHRUK Korçë SHA ka zhvilluar, të cilat kanë qenë të dedikuara për përmirësimin e sistemit Al-Billing, përtej autorizimit nga prodhuesi për këtë sistem janë pranuar oferta me sisteme ekuivalente. Pra, SHRUK Korçë SHA ka lejuar OE që të ofertojnë me sisteme ekuivalente, ndërkohë që tek kjo procedurë prokurimi objekt ankimi nuk ka lënë hapësirë për një gjë të tillë. Procedurat e prokurimit ku është lejuar ofertimi me sistem ekuivalent të Al-Billing janë:

1. Procedura aktuale në ankim administrativ pranë KPP me REF-65394-10-16-2025, me objekt “Blerje shërbimi për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit Al Billing, sistemit ËAMR, SQL server oracle, data base Omega Core Audit”, me fond limit 9 462 524 Lekë pa TVSH. Për këtë, si dokumentacion provues shërben vendimi nr.265/2026 i KPP dhe vendimi nr.1/2026 i KSHA pranë SHRUK Korçë SHA. Tek kjo procedurë prokurimi oferta e Kreatx SHPK është pranuar me sistemin ekuivalent të Al-Billing atë Flare-Billing.

2. Procedura e prokurimit publik e përmbyllur me sukses nga Kreatx SHPK me kontratën nr.335/22 prot., datë 14.10.2022, me objekt “Përditësimi i programit të faturimit, migrimi i të dhënave, audit dhe ëeb sevice për pagesat e faturave të ujit të pijshëm”, me vlerë 2 754 000 Lekë pa TVSH. Tek kjo procedurë e fundit, si dokumentacion provues do të gjeni kontratën e nënshkruar mes SHRUK Korçë SHA dhe Kreatx SHPK, tek e cila jemi shpallur fitues me sistemin ekuivalent Flare Billing. Gjithashtu, do të gjeni edhe vërtetimin e realizimit të kontratës me sukses nga AK.

Në vijim të argumentimit, fiktiviteti i kërkesës së posaçme për autorizim nga prodhuesi i sistemit Al-Billing provohet edhe nga fakti se, për vite me radhë Kreatx SHPK ka realizuar me sukses shërbimin e fiskalizimit për disa AK, duke përfshirë edhe SHRUK Korçë SHA, që kanë pasur të implementuar si sistem billingu atë Al-Billing. Në të gjitha këto raste, ofertimi i Kreatx SHPK është bërë me sistemin ekuivalent Flare Billing. Si dokumentacion provues do të gjeni:

- 1. Kontrata administrative nr.114/6 prot., datë 23.07.2024, me objekt “Shërbimi fiskalizimi të faturave të shitjes”, me vlerë 400 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Lushnjë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.1067/1 prot., datë 07.11.2025 nga AK.*
- 2. Kontrata administrative nr.159/7 prot., datë 19.05.2022, me objekt “Fiskalizimi i faturave dhe veprimeve të arkave”, me vlerë 480 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.219/1 prot., datë 27.03.2023 nga AK.*
- 3. Kontrata administrative nr.1067/5 prot., datë 02.08.2023, me objekt “Fiskalizim i faturave të shitjes”, me vlerë 491 666.5 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Lushnjë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.1533/1 prot., datë 07.11.2024 nga AK.*
- 4. Kontrata administrative nr.1736 prot., datë 31.10.2022, me objekt “Shërbimi i fiskalizimit”, me vlerë 620 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Shkodër SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing.*
- 5. Kontrata administrative nr.439/6 prot., datë 23.12.2022, me objekt “Blerje shërbimi zhvillime dhe konfigurime për sistemin e fiskalizimit të faturave tatimore elektronike”, me vlerë 340 000 Lekë pa TVSH, me autoritet kontraktor SHRUK Korçë SHA, që ka të instaluar si sistem billingu sistemin Al-Billing. Kjo kontratë është shoqëruar me vërtetimin e realizimit nr.289/1 prot., datë 20.04.2023 nga AK.*

Të gjitha sa më lart, tregojnë qartë se kërkesa e posaçme për autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar/kontratë bashkëpunimi për sistemin Al-Billing bie ndesh me praktikën administrative të prokurimit publik dhe me legjislacionin e prokurimit publik. Në këndvështrimin e mësipërm, AK duhet të heqë nga DST kërkesën e posaçme për autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar/kontratë bashkëpunimi për sistemin Al-Billing, pasi bie ndesh me nenet 2 dhe 77, të LPP.

Nga ana tjetër, qartësojë në DST nëse nevojitet apo jo autorizimi nga prodhuesit/distributori i autorizuar/kontratë bashkëpunimi për sistemin ekzistues të fiskalizimit që ka të instaluar/implementuar pranë institucionit apo nëse nevojitet autorizim nga prodhuesi për implementimin e një sistemi të ri të ndryshëm nga ai ekzistues pranë tij. Prandaj, AK duhet të sqarojë në DST të gjithë OE ofertues për zgjidhjen ekzistuese Softwareike të fiskalizimit pranë tij. Në praktikën administrative të prokurimit publik, autorizimi nga prodhuesi kërkohet vetëm për implementimin e sistemeve të reja të fiskalizimit dhe jo për mirëmbajtjen e një sistemi ekzistues.

Nëse bëhet fjalë për blerjen dhe implementimin e një sistemi të ri fiskalizimi, nevojitet autorizim prodhuesi për sistemin e ri dhe duhet të ndryshojë gjithashtu objekti i prokurimit në “Blerjen dhe implementimin e sistemit të fiskalizimit dhe mirëmbajtjen e tij”. Po kështu, për efekt të blerjes së sistemit të ri, duhet të shtohen edhe shërbimet e tjera si testimi i sistemit, migrimi i të dhënave, dorëzimi i licencave, etj. Në të njëjtën kohë, për mbarëvajtjen e punës së sistemit të ri, nevojitet shtimi në DST edhe i certifikimeve të punonjësve kompetentë për t’u implementuar atë sipas nevojave të AK.”,

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.4. e DT-ve, rezulton se është kërkuar si vijon:

2.3.4 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizimin e prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve të specifikuar vetëm për të drejtat në lidhje me procesin e fiskalizimit të faturave:*

- *Për Programin Kompjuterik “Al Billing”*

III.3.2. Në nenin 2 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.3. Në nenin 21 pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.3.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.5. Neni 41, Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se :

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat apo shërbimin që kërkon, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit, në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Në varësi të objektit të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në LPP, vendosja e kërkesave për kualifikim në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ajo e dukshme, apo jo, të cilat kanë të njëjtin efekt.

III.3.7. Në rastin konkret Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ndodhemi para kërkimit për sqarime mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për *Autorizimin nga Prodhuesi/distributori*,

të parashikuar në pikën 2.3.4. të dokumentave të tenderit pasi ka paqartësi mbi përmbushjen e kriterit mbi autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar dhe hartimit të ofertës teknike. Gjithashtu, referuar Vendimit të KSHA-së, rezulton se ky i fundit nuk i ka trajtuar paqartësitë e konstatuara nga ana e operatorit ekonomik ankimes dhe nuk ka dhënë sqarimet e tij lidhur me to. Konkretisht autoriteti kontraktor është shprehur se:

“KSHA gjykon se kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi/autori/distributori i autorizuar për sistemin Al-Billing është e ligjshme dhe e domosdoshme për kryerjen e shërbimit të fiskalizimit i cili do të integrohet në sistemin Al Billing që shoqëria disponon në rastin konkret. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi shërbimi i fiskalizimit kërkon integrim të drejtpërdrejtë me sistemin ekzistues të faturimit. Al-Billing përfaqëson një zgjidhje të plotë faturimi, ku komponentët kryesorë teknologjikë janë të ndërthurur në mënyrë të tillë që faturimi, mbyllja e tij dhe fiskalizimi të realizohen si një proces i integruar. Ndërhyrjet funksionale ndodhin në nivel procesesh dhe rrjedhash logjike, ndërsa kodi burimor dhe struktura bazë mbeten themeli i zgjidhjes, i mbrojtur nga e drejta e autorit. SHRUK Korçë SHA përdor sistemin pa të drejtë ndërhyjeje në kodin burimor, dhe për këtë arsye, nuk mund të kërkoheri sisteme ekuivalente nga operatorët ekonomikë, pasi ato nuk garantojnë funksionimin e integruar dhe të sigurt në infrastrukturën ekzistuese. Në këtë kontekst, kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi/autori/distributori i autorizuar për sistemin Al-Billing mbështetet ligjërisht në Ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”, sipas të cilit programet kompjuterike trajtohen si vepra të mbrojtura nga e drejta e autorit, dhe çdo përdorim, integrim apo shfrytëzim i tyre kërkon autorizim nga titullari i të drejtave, duke garantuar kështu që operatori ekonomik ka të gjitha lejet ligjore për të ofruar shërbimin e fiskalizimit në mënyrë të ligjshme dhe të sigurt.

Në rastin e procedurës aktuale të fiskalizimit, termi ekuivalent nuk është vendosur, dhe kjo sepse siç u shpjegua më sipër, Al-Billing përfaqëson një zgjidhje të integruar të plotë faturimi ku komponentët kryesorë teknologjikë janë të ndërthurur në mënyrë të tillë që fiskalizimi nuk mund të realizohet me sisteme të tjera, ndërsa kodi burimor dhe struktura bazë janë të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe nuk mund të zëvendësohen ose ndërhyhen nga një sistem ekuivalent. Për këtë arsye, përdorimi i termil ekuivalent në këtë procedurë nuk është i mundur dhe nuk duhet të aplikohet.”

III.3.8. Në nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” të LPP-së thuhet shprehimisht se:

“1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.”,

III.3.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka sqaruar operatorin ekonomik ankimues për paqartësitë e tij lidhur me konstatimin se: “AK nuk ka sqaruar mjaftueshëm se përse nevojitet autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar apo kontratë bashkëpunimi për sistemin e billingut dhe jo për atë të fiskalizimit” dhe këto sqarime duhet tua komunikojë të gjithë ofertuesve, në përputhje me nenin 75 të LPP-së si më sipër cituar.

III.3.10. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit se: “kur kërkohet përmirësimi i sistemit AL - Billing si prokurim publik i posaçëm, AK ka detyrimin që të vendosë në DST termin ekuivalent pas këtij emrit të sistemit, duke pranuar edhe oferta nga OE me sisteme ekuivalente”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.3.10.1. Në rastin konkret, referuar ankeses se operatorit ekonomik, si dhe nga shqyrtimi i kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit, Komisioni gjykon, se kërkesa për autorizimin e prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar për objektin e prokurimit ose kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e sistemeve të specifikuar vetëm për të drejtat në lidhje me procesin e fiskalizimit të faturave: Për Programin Kompjuterik “Al Billing”, duhet parashikuar në përputhje me përcaktimet ligjore, duke lejuar edhe mundësinë e plotësimit të kërkesës së sipërcituar me alternativa të tjera ekuivalente.

K.P.P. gjykon se synimi bazë i autoritetit kontraktor në vendosjen e kriterëve për kualifikim është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e duhura për kryerjen e shërbimit të kërkuar dhe me cilësinë e kërkuar, por gjithnjë duke vlerësuar që këto kërkesa të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, me rëndësinë e tij në mbarëvajtjen e punës së autoritetit kontraktor, por mbi të gjitha bazuar në legjislacionit përkatës.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.3.11. Gjithashtu në pikën 4 të ankesës, shoqëria “Kreatx” SHPK shprehet se: *“Po kështu, për efekt të blerjes së sistemit të ri, duhet të shtohen edhe shërbimet e tjera si testimi i sistemit, migrimi i të dhënave, dorëzimi i licencave, etj. Në të njëjtën kohë, për mbarëvajtjen e punës së sistemit të ri, nevojitet shtimi në DST edhe i certifikimeve të punonjësve kompetentë për t’u implementuar atë sipas nevojave të AK.”*

III.3.11.1. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e ankimuesit për shtimin e shërbimeve dhe certifikimeve të punonjësve, në thelb kanë të bëjë me shtim kërkesash dhe jo me pretendime për modifikimin e kriterëve, të konsideruara diskriminuese, të cilat do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*. KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor.

Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do t’i nënshtrohet kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin të parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*. Në këtë kontekst, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriterin minimal, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së

prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 germa “b” të lex specialis parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kriteret kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kriterëve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kriteret të reja që do të rëndonin pozitat e operatorëve ekonomikë të interesuar.

Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë kërkesa sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kërkesa në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-77629-02-26-2026, me objekt: “Shërbimi i fiskalizimit të faturave”, me fond limit 2,486,000.00 lekë pa tvsh,

parashikuar për t'u zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

2. Autoriteti kontraktor, të kryejë sqarimet dhe modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

